



Qendra për Arsim e Kosovës  
Kosova Education Center

**KEC**

Kodi: 006

## **HAP PAS HAPI**

Trajnimi fillestar për motra edukatore që punojnë me fëmijë të moshës 0-3 vjecare

### Qëllimet e Programit

Me përvetësimin e këtij programi pjesëmarrësit përfitojnë:

- Njohjen e *koncepteve* të përgjithshme *filozofike* dhe bazën teorike të programit me në qendër fëmijën
- Njohjen e *praktikave të përshtatshme zhvillimore* që mbajnë parasysh fëmijën në tërësi si qenie intelektuale, sociale dhe emocionale
- Njohje mbi zhvillimin e trurit të fëmijet e moshes 0-3 vjecare
- Aftësi për organizimin e *mësimit të individualizuar*, që nënkupton respektimin e potencialit zhvillimor të secilit individ në aspektin psiko-social, fizik, shoqëror, gjinor
- Aftësi për krijimin e mundësive për liri të shprehjes, të drejtën për zgjedhje dhe vendosjen për përgjegjësi që reflektojnë *frymën demokratike në klasë*
- Aftësi për *planifikimin e rutinave ditore*
- Shkathtësi për *vëzhgimin e fëmijës dhe vlerësimin e efekteve të punës në klasë*
- Ide për krijimin e një *ambienti stimulues për mësimnxënie aktive*
- Njohuri për *përfshirjen e familjes në realizimin e programit*

## Përmbajtja e trajnimit fillestar për klasën e parë

Hyrje dhe vështrim i përgjithshëm i metodologjisë me në qendër fëmijën, cka dijmë për foshnjat, zhvillimi i fëmiut si individ – temperamenti, zhvillimi i trurit te foshnjat, zhvillimi emocional, zhvillimi social, zhvillimi i të folurit, zhvillimi fizik, loja sensorike, si mësojnë foshnjat, të mësuarit përmes lojës, vëzhgimi ambienti stimulues, të mësuarit përmes rutinës, mbarimi i librave dhe lodrave, familja dhe komuniteti, puna ekipore, materialet recikluese.

## Grupi i synuar

Ky program u dedikohet motrave edukatore të cilat punojnë me fëmijë të moshës 0-3 vjeçare, të punësuarve në administratë arsimore, zyrtarëve të arsimit, pedagogëve, profesorëve dhe studentëve të Universitetit, si dhe trajnerëve të programit.

## Forma e organizimit/Kohëzgjatja

Trajnimi fillestar për motra edukatore realizohet me anë të një trajnimi pesë ditor, që përfshin gjithsej 40 orë. Ky trajnim pasohet me 4 punëtori njëditore gjatë një viti akademik. Me qëllim që të përcillet puna në kontinuitet dhe të punohet sa më shumë në cilësi të punës cdo muaj parashihen monitorime në klasë.

## Certifikimi

Kusht për certifikim është pjesëmarrja 90% në trajnim.